



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 146, datë 14.12.2022

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT DHE DETAJIMIT TË SHITESËS SË FONDEVE TË RINDËRTIMIT PËR VITIN 2022, AKORDUAR NË FORMËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEA PALLAT DHE NJËSI INDIVIDUALE, SI DHE RIKONSTRUKSIONIN DHE RIPARIMIN E MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTEA (PALLAT) NË BASHKINË DURRËS

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.768, datë 12.12.2022 “Për një shtesë në Vendimin nr. 201, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në bashkitë Durrës dhe Kamzë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.770, datë 12.12.2022 “Për një shtesë në Vendimin nr. 613, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Durrës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.773, datë 12.12.2022 “Për një shtesë në vendimin nr. 715, datë 24.11.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit e të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë”, Vendimit të Këshillit

të Ministrave nr.797, datë 12.12.2022 “Për një shtesë në Vendimin nr. 935, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe banesave individuale, në bashkitë Durrës dhe Lezhë”, të ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit dhe detajimit të shtesës së fondeve të rindërtimit, për vitin 2022, me vlerë 1'639'918'081 (një miliard e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e një) lekë pa tvsh, alokuar në formën e transfertës së pakushtëzuar për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa pallat dhe njësi individuale, si dhe rikonstruksionin dhe riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr.	Emërtimi i Projektit	Kodi i programit	Llograia Ekonomike	Kodi i Produktit	Financimi shtesë për vitin 2022
1	Riforcimi njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit	04960	231	94902AB	1,329,371,813
2	Rikonstruksioni dhe riparimi mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat)	04960	231	94902AB	310,546,268
	TOTALI	04960	231	94902AB	1,639,918,081

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 16.12.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 933/prot.
3

Durrës, më 20.12.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.146 datë 14.12.2022 “Për miratimin e përdorimit dhe detajimit të shtesës së fondeve të rindërtimit për vitin 2022, akorduar në formën e transfertës së pakushtëzuar për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa pallat dhe njësi individuale si dhe rikonstruksionin dhe riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Durrës.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

